

VENDIM
Nr. 487, datë 25.7.2012

**PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SKEMËS SË FINANCIMIT E BASHKËFINANCIMIT
TË TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR MBËSHTETJEN E GJELBËRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondin prej 10 për qind të transfertës së pakushtëzuar, të ndarë sipas ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, që komunat dhe bashkitë nuk e kanë përdorur për skemën e financimit të pemëtarisë, duhet ta përdorin për gjelbërim, me qëllim përmirësimin e treguesve të mjedisit.

2. Sipërfaqet që do të gjelbërohen, duhet të ndodhen brenda juridiksionit administrativ të komunës ose bashkisë.

3. Fondi i transfertës së pakushtëzuar, i përcaktuar në pikën 1, do të përdoret për:

a) krijimin e parqeve të reja apo rehabilitimin e atyre ekzistuese, por që kanë humbur funksionin si të tilla, duke i pyllëzuar me drurë të ndryshëm pyjorë;

b) gjelbërimin e territoreve publike të shkollave, kopshteve, çerdheve, qendrave shëndetësore, rrugëve, institucioneve dhe objekteve të ndryshme social-kulturore;

c) pyllëzimin e territoreve të kërcënuara nga ndotjet industriale;

ç) pyllëzimin e sipërfaqeve të eroduara, të rrezikuara nga rrëshqitjet dhe që paraqesin rrezik për infrastrukturën dhe zonat e banuara apo ato industriale;

d) pyllëzimin e shtretërve të lumenjve dhe kthimin e tyre në zona rekreative për njerëzit apo prodhimin e biomasës me cikël të shkurtër prodhimi për energji të rinovueshme;

dh) pyllëzimin e sipërfaqeve përreth varrezave;

e) pyllëzime të integruara me kultura bujqësore e kullimore për krijimin e sistemeve agro-pyjore e silvo-pastorale.

4. Sipërfaqet që do të përdoren për krijimin e parqeve apo zonave të gjelbëruara, duhet të plotësojnë këto kushte:

a) të jenë pronë publike e patjetërsueshme;

b) të mos jenë objekt pretendimi për rikthimin e pronës ish-pronarëve;

c) të mos jenë objekt tjetërsimi si pasojë e investimeve publike të miratuara më parë;

ç) të mos jenë objekt i studiuar dhe i miratuar për ndërtime urbane apo vepra industriale;

d) të jenë të lidhura me infrastrukturë rrugore.

5. Llojet e drurëve që do të mbillen, duhet të plotësojnë kërkesat, si më poshtë:

a) t’u përshtaten kushteve klimatike tokësore në zonën ku do të mbillen;

b) përparësi t’u jepet specieve me përdorim kompleks (frutore-pyjore) ose llojeve tradicionale e autoktone, që synojnë ruajtjen e biodiversitetit dhe sigurinë ushqimore;

c) fidanët të jenë të certifikuar.

6. Në rastet kur sipërfaqet që do të pyllëzohen për t’u kthyer në park apo zonë të gjelbëruar janë fond pyjor në pronësi shtetërore, Ministria e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të akteve ligjore, t’i kalojë këto sipërfaqe në pronësi të komunave dhe bashkive.

7. Komunat apo bashkitë fondin e transfertës së pakushtëzuar duhet ta planifikojnë për t’u përdorur brenda vitit buxhetor, duke realizuar projektet përkatëse për pyllëzimin e sipërfaqeve, për krijimin e parqeve dhe zonave të gjelbëruara dhe mbrojtjen e tokës nga erozioni.

8. Skema e financimit të projekteve me fondin e transfertës së pakushtëzuar të jetë në përputhje me nivelin e realizimit të punimeve për pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqeve për t’u kthyer në parqe dhe zona të gjelbëruara.

9. Komunat dhe bashkitë, pas punimeve për mbjelljen e drurëve pyjorë, duhet të kryejnë të gjitha shërbimet për mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e këtyre objekteve.

10. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të bashkëpunojë me njësitë e qeverisjes vendore, duke monitoruar punimet që do të kryhen sipas fazave deri në realizimin e plotë të tyre dhe të hartojë një raport për Ministrinë e Financave.

11. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe komunat e bashkitë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha